



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

Nr. 84/P8 Prot.

Datë 13.07.2022

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.79, dt.13.07.2022

Në bazë të dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.15, datë 30.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm :

“Mbi mënyrën e ndjekjes, raportimit, vlerësimit, trajtimit dhe administrimit të raportimeve mbi veprat penale që ndiqen sipas kuptimit të nenit 59 të K.Pr.Penale dhe raportimeve mbi fakte/ngjarje që dukshëm nuk përmbajnë elementë të ndonjë vepre penale të parashikuar nga ligji”

Mbështetur në ligjin nr. 97/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal”, i ndryshuar, ligjin nr.7905, dt.21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar, ligjin nr.25/2019

“Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” i ndryshuar, ligjin nr.108/2014 “Për policinë e shtetit” i ndryshuar, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.2, dt.29.12.2016 “Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.3, dt.29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Memorandumin e Mirëkuptimit me Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1460 prot., dt.30.09.2022, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.15, datë 30.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për trajtimin e njoftimeve nga viktimat akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale” si dhe Urdhërin nr.11, datë 15.02.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë “Për krijimin e Regjistrimit të njoftimeve të viktimave akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale” dhe Regjistrimit të çështjeve të tjera” si dhe duke pasur në konsideratë Urdhërin nr.942, datë 26.11.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Me qëllim :

- *Lehtësimin e zbatimit të Memorandumin e Mirëkuptimit me Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1460 prot., dt.30.09.2022, Udhëzimit të Përgjithshëm nr.15, datë 30.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për trajtimin e njoftimeve nga viktimat akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale” ;*
- *Përmirësimin e cilësisë së referimeve nga policia gjyqësore ;*
- *Uljen e ngarkesës jo-reale dhe të panevojshme të punës në prokurori ;*
- *Zgjidhjen e problematikave të ndjekjes penale të veprave penale për të cilat parashikohet ndjekje penale nga viktimat akuzuese ;*
- *Unifikimin e rregullave të qarta dhe të sakta në lidhje me marrjen e njoftimit, përpunimin, vlerësimin dhe ndjekjen e veprave penale që*

parashikohen nga neni 59 i K.Pr.Penale dhe fakteve dukshmën të natyrës jo-penale ;

- *Shmangien e praktikave aktuale që sjellin zvarritje të pajustificuara në hetime ;*
- *Rritjen e produktivitetit në veprimtarinë hetimore dhe gjyqësore të prokurorisë ;*
- *Utilizimin e instrumentave të brendshëm për të trajtuar nevojën e adresimit të saktë të njoftimeve për fakte të ndryshme nga policia gjyqësore ;*
- *Qartësimin e kushteve dhe modaliteteve për të përmirësuar qasjen mbi zbatimin e nenit 59 të K.Pr.Penale dhe referimeve mbi faktet jo-penale ;*
- *Uljen e numrit të pajustificuar të lartë të mosfillimeve të çështjeve penale të shkaktuar si rrjedhojë e referimeve të panevojshme ;*
- *Forcimin e sensibilizimit dhe ekspertizës profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore që vijojnë të moszbatojnë Memorandumin e Mirëkuptimit duke referuar material hetimore në një kohë që duhet të zbatonin Memorandumin e Mirëkuptimit ;*
- *Konsolidimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit institucionale prokurori-polici e shtetit ;*
- *Garantimin e parimit të aksesit në drejtësi ;*
- *Zgjidhjen e disa situatave nga praktika administrative dhe procedurale të cilat Udhëzimi nr.15/2020 i PP, ometon t'i trajtojë ;*
- *Unifikimin e veprimtarisë procedurale dhe administrative të policisë gjyqësore dhe prokurorisë që nga marrja njoftim dhe deri në arkivimin e një praktike raportimi sipas Memorandunit të Mirëkuptimit ;*
- *Zgjerimin e zbatueshmërisë së Udhëzimit nr.15/2020 të PP nëpërmjet përshtatjes së klauzolave të tij sipas veprimtarisë administrative dhe procedurale të konsoliduar me akte të brendshme në fuqi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe evitimin e rasteve të kolizionit mes disponimeve të ndryshme në të ;*
- *Evidentimin e personit përgjegjës në rast situatë problematike ;*
- *Kontrollin e zbatimit të afatit të arsyeshëm si pjesë e procesit të rregullt ligjor të garantuar kushtetushmërisht ;*
- *Konsolidimin e dilijencës në hetime nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore ;*

- *Qartësimin e veprimtarisë së administratës së prokurorisë çështjet e raportuara nga policia gjyqësore ;*
- *Konsolidimin e rregullave të qarta mbi mënyrën e mbajtjes dhe administrimit të regjistrave ;*
- *Forcimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorëve.*

U D H Ë Z O J :

Neni 1

Fusha e veprimit

1. Ky udhëzim ka efekt mbi shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe në Komisarariatet e Policisë në varësi të saj, si dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksionit në prokurori, të cilat kanë detyrimin të raportojnë në prokurori veprat penale e përfshira në nenin 59 të K.Pr.Penale apo njoftimet mbi faktet e dukshme jo-penale, sipas Memorandumit e Mirëkuptimit mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1460 prot., dt.30.09.2022 dhe akteve në zbatim të tij.

Neni 2

Marrja dhe trajtimi i raportimeve nga policia gjyqësore

1. Oficerët e policisë gjyqësore pasi marrin njoftim mbi veprat penale që ndiqen drejtpërdrejtë në gjykatë nga viktima akuzuese sipas nenit 59 të K.Pr.Penale apo për ngjarjet/faktet/kallëzimet të cilat dukshëm nuk përmbajnë elementë të ndonjë vepre penale të parashikuar nga ligji, veprojnë në këtë mënyrë :
 - a. Kryejnë veprimet e nevojshme verifikuese me qëllim për t'u siguruar plotësisht për kualifikimin ligjor të faktit apo mungesën e parashikueshmërisë penale të faktit.

- b. Përpilojnë aktin “Raportim i veprës penale tek prokurori” në rastet kur marrin dijeni për një vepër penale që ndiqet drejtpërdrejtë në gjykatë nga viktimat akuzuese sipas nenit 59 të K.Pr.Penale, sipas modelit të miratuar në Memorandumin e Mirëkuptimit mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1460 prot., dt.30.09.2022.
- c. Përpilojnë aktin “Raportim mbi marrjen dijeni të faktit” në rastet kur marrin dijeni për një fakt që dukshëm nuk plotëson elementët e ndonjë veprë penale të parashikuar nga ligji, sipas modelit të miratuar në Memorandumin e Mirëkuptimit mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1460 prot., dt.30.09.2022.
- d. Përpilojnë aktin “Njoftim mbi faktin e kallëzuar” në rastet kur marrin dijeni për një fakt apo rrethanë që dukshëm nuk plotëson elementët e ndonjë veprë penale të parashikuar nga ligji.
- e. Përcjellin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan aktet e raportimeve dhe njoftimeve të sipërcituara.

Neni 3

Marrja dhe trajtimi i raportimeve nga prokuroria

1. Raportimet e përcjella nga policia gjyqësore regjistrohen në një regjistër të posaçëm të krijuar sipas Urdhërit nr.11, datë 15.02.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë.
2. Raportimi i përcjellë nga policia gjyqësore regjistrohet në librin e protokollit hyrës të prokurorisë të administruar nga Zyra e Protokollit.
3. Më pas, raportimi kalon tek Drejtuesi i Prokurorisë, i cili bën shënimet përkatëse, sipas dispozitave të këtij udhëzimi.
4. Në vijim si rregull, raportimi kalon pranë Zyrës së Regjistrimit për të vepruar sipas dispozitave të këtij udhëzimi dhe në vijim pranë Zv.Drejtesit të Prokurorisë/Drejtesit të Seksionit të gatshëm.

5. Raportimi që ka vend për diskutim dhe analizë, i kalon Zv.Drejtnesit të Prokurorisë ose Drejtnesit të Seksionit të gatshëm për të bërë shënimet përkatëse.
6. Lëvizja e brendshme e materialeve sipas këtij udhëzimi i nënshtrohet rregullave në fuqi për lëvizjen dhe regjistrimin e akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Neni 4

Detyrimet e oficerit të policisë gjyqësore

1. Policia gjyqësore përmbush të gjitha detyrimet dhe ushtron të gjitha kompetencat e përcaktuara në K.Pr.Penale dhe ligjin organik nr.25/2019.
2. Oficeri i policisë gjyqësore që merr dijeni për veprën penale që ndiqet sipas nenit 59 K.Pr.Penale apo faktet dukshëm jo-penale ka detyrim të sqarojë kallëzuesin apo viktimën mbi veprimet që do të kryhen prej tij dhe mënyrën e raportimit prej tij në prokurori në lidhje me këto fakte.
3. Oficeri i policisë gjyqësore orienton viktimën në rastet e nenit 59 të K.Pr.Penale që mund të bëjë drejtpërdrejtë në gjykatë një kërkesë ankimore penale, dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar, si dhe e pajis me një kopje të akteve procedurale të nevojshme për këtë qëllim, të administruara deri në atë moment.
4. Oficeri i policisë gjyqësore administron sipas rregullave administrative të vendosura nga institucioni të cilit i përket, të gjitha aktet procedurale të veprimeve verifikuese që lidhen me faktin e raportuar.

Neni 5

Mënyra trajtimit në prokurori të referimeve që duhen raportuar

1. Në rastet kur nga policia gjyqësore referohen në Prokurorinë e pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan materiale hetimore për

veprat penale që parashikohen nga neni 59 i K.Pr.Penale apo për fakte dukshëm jo-penale, veprohet në këtë mënyrë :

- a. Për faktet dukshëm jo-penale, pas shënimit përkatës nga Drejtuesi ose Zv.Drejtuesi i Prokurorisë/Drejtuesi i Seksionit i Gatshëm, bëhet kthimi i materialeve në shërbimin e policisë gjyqësore referues, me kërkesën që prej oficerit të bëhet raportimi mbi faktin jo-penal sipas Memorandumit të Mirëkuptimit dhe akteve në zbatim të tij.
- b. Për referimet që kualifikohen qartësisht në kuadrin e nenit 59 K.Pr.Penale, pas shënimit përkatës nga Drejtuesi ose Zv.Drejtuesi i Prokurorisë/Drejtuesi i Seksionit i Gatshëm, bëhet kthimi i materialeve në shërbimin e policisë gjyqësore referues, me kërkesën që prej oficerit të bëhet raportimi mbi veprën penale sipas Memorandumit të Mirëkuptimit dhe akteve në zbatim të tij.
- c. Për referimet që nuk mund të kualifikohen qartësisht në kuadrin e nenit 59 K.Pr.Penale, pas shënimit përkatës nga Drejtuesi ose Zv.Drejtuesi i Prokurorisë/Drejtuesi i Seksionit i Gatshëm, Zyra e Regjistrimit bën administrimin e përkohshëm të këtij materiali deri në plotësimin me aktet e nevojshme dhe më pas veprohet në varësi të rezultatit të aktit të administruar sipas pikës “b” të këtij neni ose procedohet me regjistrimin e materialit në regjistrin e njoftimit të veprave penale.
- d. Në çdo rast që përpunojnë një material raportues, Drejtuesi ose Zv.Drejtuesi i Prokurorisë/Drejtuesi i Seksionit i Gatshëm, mund t'i kërkojnë policisë gjyqësore të kryejnë veprime verifikuese shtesë dhe/ose administrimin e akteve të tjera, me qëllim arritjen e një konkluzioni sa më objektiv mbi raportimin.
- e. Si rregull, për kthimin e materialeve sipas këtij neni kujdeset Zv.Drejtuesi i Prokurorisë, i cili përpilon edhe shkresat përcjellëse përkatëse.

Neni 6

Mënyra trajtimit në prokurori të raportimeve që duhen referuar

1. Në rastet kur nga policia gjyqësore përcillen në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan raportime sipas Memorandumit të Bashkëpunimit, por që në fakt duhet të ishin referuar materialet hetimore për shkak se vlerësohet se ka elementë të veprave penale që ndiqen kryesisht ose me ankim, Zyra e Regjistrimit bën evidentimin e këtij raportimi në regjistrin sipas Urdhërit nr.11, datë 15.02.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë.
2. Pas shënimit përkatës nga Drejtuesi i Prokurorisë ose Zv.Drejtuesi dhe analizës e vlerësimit të rastit, Zyra e Regjistrimit bën kthimin e materialit pranë shërbimit të policisë gjyqësore që ka raportuar, me kërkesën që prej oficerit të bëhet referimi i veprës penale tek prokurori sipas rregullave të K.Pr.Penale.
3. Nëse materialet janë të plota, Drejtuesi i Prokurorisë ose Zv.Drejtuesi i Prokurorisë/Drejtuesi i Seksionit i Gatshëm, urdhërojnë Zyrën e Regjistrimit të regjistrojë dhe shportojë materialin hetimor sipas rregullave të regjistrimit dhe shortimit të njoftimeve të veprave penale.
4. Si rregull, për kthimin e materialeve sipas këtij neni kujdeset Zv.Drejtuesi i Prokurorisë, i cili përpilon edhe shkresat përcjellëse përkatëse.

Neni 7

Njoftimet drejtpërdrejtë në prokurori

1. Në rastet kur njoftimi për vepra penale që ndiqen sipas nenit 59 të K.Pr.Penale apo njoftimi për ngjarje/fakte që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprave penale, bëhet drejtpërdrejtë në prokurori, nepërmjet paraqitjes personalisht të viktimës/kallëzuesit apo përfaqësuesit ligjor (përjashton kallëzimet apo ankimet me postë), oficeri i policisë gjyqësore i seksionit të prokurorisë pasi merr njoftim për faktin, bindet për kualifikimin ligjor dhe kryen veprimet e nevojshme verifikuese, kryen raportimin sipas modeleve të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Akti raportues i oficer të seksionit trajtohet sipas rregullave të këtij udhëzimi.
3. Në këtë rast, oficeri i policisë gjyqësore i seksionit është oficeri i caktuar për të ndjekur rastin sipas akteve të brendshme në fuqi dhe konform kompetencës lëndore të seksioneve të kësaj prokurorie.

Neni 8

Regjistri i raportimeve dhe njoftimeve

1. Në zbatim të Urdhërit nr.11, datë 15.02.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë nga Zyra e Regjistrimit mbahet dhe administrohet regjistri sipas modelit të përcaktuar në Memorandumin e Mirëkuptimit mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1460 prot., dt.30.09.2022.
2. Ky regjistër, plotësimi dhe saktësia e përmbajtjes së tij, janë nën përgjegjësinë e Zyrës së Regjistrimit. Zyra e Regjistrimit zbaton rregullat dhe metodologjinë tekniko-profesionale për mbajtjen dhe plotësimin e regjistrimit.
3. Regjistri i njoftimeve të viktimave akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale hapet me nr.rendor 1 në çdo fillim viti kalendarik dhe mbyllet në datë 31 dhjetor të atij viti.
4. Zyra e Regjistrimit fillon punën për krijimin dhe administrimin, nga viti 2022 e në vijim, të regjistrimit elektronik të raportimeve të viktimave akuzuese dhe të fakteve që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale.

Neni 9

Administrimi, administrimi i përkohshëm dhe arkivimi i raportimeve

1. Zyra e Regjistrimit administron raportimet e përcjella nga policia gjyqësore, duke krijuar praktikë të veçantë për çdo raportim, të cilës i bashkëngjitet çdo akt apo shkresë që lidhet me të.

2. Çdo praktikë raportimi evidentohet në regjistër dhe mbi të shënohet një numër, i cili i korespondon numrit rendor të evidentuar në regjistër për këtë raportim.
3. Për nevoja të përditshme pune dhe të ndjekjes penale, praktikat e raportimeve që i përkasin një viti kalendarik administrohen përkohësisht në Zyrën e Regjistrimit.
4. Në muajin janar të vitit pasardhës, pas mbylljes së regjistrimit të vitit të shkuar dhe hapjes së regjistrimit të ri, Drejtuesi i Prokurorisë ose Zv.Drejtuesi i Prokurorisë/Drejtuesi i Seksionit, bën shënimin A/A (akti në arkivë) mbi çdo raportim sipas Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjinë e Shërbimit Arkivor në RSH dhe më pas praktikat vjetore të arkivimit kalojnë nga Zyra e Regjistrimit në Arkivën e prokurorisë. Kalimi bëhet sipas një inventari që nënshkruhet nga dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim.

Neni 10

Administrimi i materialeve bashkëlidhur raportimit

1. Oficeri i policisë gjyqësore që përcjell raportimet në prokurori mban dhe administron kopjen origjinale të materialeve dhe akteve procedurale të veprimeve verifikuese të kryera deri në atë moment.
2. Nëse këto materiale përcillen në prokurori së bashku me raportimin përkatës, nga Zyra e Regjistrimit merren masa që materialet procedurale bashkëlidhur raportimit të kthehen në origjinal pranë shërbimit të policisë gjyqësore që ka kryer raportimit, duke mbajtur një kopje të këtyre akteve.

Neni 11

Modelet e akteve

1. Aktet e raportimeve dhe njoftimeve sipas këtij udhëzimi plotësohen nga policia gjyqësore sipas modeleve të miratuara.
2. Ato përpilohen në tre kopje, ku një administrohet nga oficeri i policisë gjyqësore, një përcillet në prokurori dhe një kopje i jepet viktimës/kallëzuesit.

Neni 12

Trajnimi i policisë gjyqësore

1. Zv.Drejtuksi i Prokurorisë brenda muajve janar dhe korrik të çdo viti thërret në mbledhje oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve dhe seksioneve me qëllim trajnimin e tyre për zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe akteve në zbatim të tij si dhe njohjen e oficerëve me modelet e akteve raportuese/njoftuese.

Neni 13

Dispozita të fundit

1. Drejtuesi i Prokurorisë, Zv.Drejtuksi i Prokurorisë, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve të policisë gjyqësore si dhe punonjësit administrativ të prokurorisë janë përgjegjës për zbatimin e disponimeve të këtij udhëzimi.
2. Çdo veprim ose mosveprim në kundërshtim me sa më sipër përbën shkak për përgjegjësi sipas ligjit.
3. Ngarkohet Zv.Drejtuksi i Prokurorisë për të ndjekur zbatimin e përcaktimeve të këtij udhëzimi dhe detyrimeve të tjera ligjore dhe nënligjore nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksionit dhe shërbimeve. Në çdo rast Zv.Drejtuksi i Prokurorisë informon me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë për problematikat e hasura.
4. Në këtë udhëzim, kompetencat e Drejtuesit të Prokurorisë, mund të ushtrohen nga Zv.Drejtuksi apo Drejtuesi i Seksionit, vetëm në mungesë të Drejtuesit të Prokurorisë dhe sipas aktit përkatës të delegimit të kompetencave.
5. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë prokurorët, oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe pranë shërbimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe Komisariatet e Policisë Elbasan, Gramsh, Peqin, Cërrik, Librazhd si dhe pranë të gjitha shërbimeve të

- policisë gjyqësore në institucione të tjera. Një kopje e këtij udhëzimi i 'u komunikohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al. Ngarkohet specialisti IT me kryerjen e njoftimit.
6. Një kopje e këtij urdhëzimi i dërgohet Prokurorisë së Përgjithshme për publikim në web në zbatim të nenit 46/5 të ligjit nr.97/2016.
 7. Shfuqizohet çdo akt tjetër për pjesën që bie në kundërshtim me këtë udhëzim.
 8. Ky udhëzim hyn në fuqi më datë 13.07.2022

DREJTUES I PROKURORISË

Kreshnik AJAZI

